

K Ë R K E S Ë

GJYKATËS SË RRETHIT TË KORÇËS

Kërkuese: Mimoza Guri Qori e datëlindjes 1966, lindur e banuese në Pojan.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim Besim Qori në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Jam bashkëshortja e Besim Qorit. Me të kemi bashkëjetuar me martesë prej 14 vjetësh. Bashkëshorti im Besim ka qenë i sëmurë mendërisht. Kohët e fundit sëmundja e tij ishte shtuar. Por pavarësisht nga sëmundja ne nuk e kishim mjekuar apo çuar te mjekët.

Më 24.8.1998 ai është larguar nga shtëpia dhe nuk është kthyer më. Është larguar vetë dhe deri tani nuk është bërë i gjallë. Në gjendjen që ka qenë, ne me gjithë kërkimet e shumta nuk kemi marrë asnjë dijeni nëse është gjallë apo jo.

Përderisa ka mëse një vit që nuk ka asnjë njoftim të jetë sistemuar, do të thotë se ai është zhdukur.

Me këtë gjendje ne kemi interes të vërtetojmë e shpallim zhdukjen e tij.

KËRKUESJA

Mimoza Qori